

Në bazë të dispozitës së nenit 21. paragrafi 2. nënparagrafi 2.3, dhe 2.5, të Ligjit Nr.08/L-018 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të dhuratave, nenit 2 paragrafi 2. të Ligjit Nr.08/L-017 për parandalimin e Korrupsionit, Menaxhmenti i KRU "Hidromorava"-SH.A. në Gjilan, përmes Kryeshefit Ekzekutiv me datë 05.03.2024, merr këtë,

## V E N D I M

I. Caktohet zyrtari kontaktuese në KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan për pranimin, evidentimin dhe kontrollin e regjistrit të dhuratave konform Ligjit nr.08/L-108 për Deklarimin , Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

II. Zyrtari kontaktues si në pikën I. të këtij vendimi është:

**1. Z. Ilir Uruqi**

III. Detyrë e zyrtarit kontaktues të cekur në pikën II. të këtij vendimi është të veproj sipas nenit 21. paragrafi 2 nënparagrafi 2.3, dhe 2.5, të Ligjit Nr.08/L-018 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të dhuratave lidhur me përcaktimin e procedurës për trajtimin e rasteve.

IV. Për kryerjen e detyrës si në pikën e III. të këtij vendimi, zyrtari kontaktues i raporton Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Hidromorava"-SH.A. Gjilan.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.



**Kryeshefi Ekzekutiv**

**(Ymer Salihu)**

### Dorëzohet:

- Z. Ilir Uruqi ;
- Sektorit për burime njerëzore;
- Në dosje.